



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr 135, datë 30.09.2020

“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZUESIT PËR DETAJIMIN E PROCEDURAVE PËR TË PËRFITUAR NGA NËNPROGRAMI I GRANTIT TË RIKONSTRUKSIONIT DHE PROGRAMET E PROCESIT TË RINDËRTIMIT”

Në nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 29, pika 1, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; nenit 30, shkronja “gj” dhe nenit 41, të ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019; ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”, pikës 5, të Kreut IV, të vendimit nr. 5, datë 6.1.2020, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, të ndryshuar; vendimin nr. 301, datë 15.04.2020, të Këshillit të Ministrave “Për normat e stehimit si dhe kushtet e standardet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët” vendimit nr. 157, datë 27.12.2019, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2020-2022 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2020”, të ndryshuar, me propozimin e kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

Në vendimet për miratimin e udhëzuesve “Për detajimin e procedurave për të përfituar nga nënprogrami i grantit të rikonstruksionit dhe nga programet e procesit të rindërtimit”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në udhëzuesin “Për detajimin e procedurave për të përfituar nga nënprogrami i grantit të rikonstruksionit”, i miratuar sipas pikës 2 të vendimit nr. 57, datë 01.06.2020 “Për përcaktimin e masës së vlerës së rikonstruksionit ose riparimit dhe miratimin e udhëzuesit “Për detajimin e procedurave për të përfituar nga nënprogrami i grantit të rikonstruksionit”, bëhet kjo shtesë:

a. Në kreun IX, në pikën 9 të “Fazës së dytë të aplikimit”, shtohet shkronja “b/1” me përmbajtjen si më poshtë vijon:

“b/1. Përjashtimisht, nëse pas verifikimit në sistem konstatohet se individi/familja ka në bashkëpronësi ose posedim të ligjshëm, më shumë se një banesë në territorin e Bashkinë Tiranë e cila/të cilat rezultojnë të ketë/kenë një sipërfaqe nën normat e stehimit të përcaktuara në vendimin nr. 301, datë 15.04.2020, të Këshillit të Ministrave “Për normat e stehimit si dhe kushtet e standardet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat

me kosto të ulët” si edhe bazuar në nenet 3 deri 10, të ligjit nr.22/2018, “Për strehimin social”, ku norma e strehimit është 30 m² sipërfaqe neto për personin e parë dhe sipërfaqja neto shtohet me 10m² për çdo person shtesë, dhe ku pas kryerjes së përlllogaritjeve konstatohet se në sipërfaqen e banesës/banesave të tjera nuk mund të banojë/banojnë dot individi/familja për shkak të mospërmbushjes së kësaj norme, individi/familja nuk do të skualifikohet dhe aplikimi përkatës do të ndjekë procedurat e parashikuara në këtë udhëzues.”

2. Në vendimin nr. 70, datë 12.06.2020 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e udhëzuesit “Për detajimin e procedurave për të përfutuar nga programet e procesit të rindërtimit”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a. Në pikën 5, të kreut IX, në të cilën është përcaktuar lista e hartuar nga AKSHI, për dokumentet që provojnë pronësinë, shtohet dokumenti si më poshtë vijon:

“Vërtetimin e lëshuar nga njësia administrative/lagjia, për dy ose më shumë familje që rezultojnë të kenë banuar në të njëjtën banesë të dëmtuar si pasojë e tërmetit të rënë më 26.11.2019”.

b. Në kreun IX, “Faza e dytë e aplikimit”, në fund të pikës 5 shtohet paragrafi me përmbajtje si më poshtë vijon:

“Përfundimisht për banesat e dëmtuara si pasojë e tërmetit të rënë më 26 nëntor 2019, ku rezultojnë të kenë banuar dy apo më shumë familje, të konfirmuara përmes vërtetimitpërkatës që lëshohet nga njësia administrative/lagjia, secili prej aplikimeve të kryera do të ketë mundësinë që të përfutojnë sipas procedurave të parashikuara në këtë udhëzues”.

c. Në kreun IX, ”Faza e dytë e aplikimit”, në pikën 6, shtohen shkronjat “c” dhe “d” me përmbajtje si më poshtë vijon:

“c. Përfundimisht, nëse pas verifikimit në sistem konstatohet se individi/familja ka në pronësi/bashkëpronësi ose posedim të ligjshëm, më shumë se një banesë në territorin e Bashkinë Tiranë e cila/të cilat rezultojnë të ketë/kenë një sipërfaqe nën normat e strehimit të përcaktuara në vendimin nr. 301, datë 15.04.2020, të Këshillit të Ministrave “Për normat e stehimit si dhe kushtet e standardet për banesat sociale me qira që blihen nëtreg dhe banesat me kosto të ulët” si edhe bazuar në nenet 3 deri 10, të ligjit nr.22/2018, “Për strehimin social”, ku norma e strehimit është 30 m² sipërfaqe neto për personin e parë dhe sipërfaqja neto shtohet me 10m² për çdo person shtesë, dhe ku pas kryerjes së përlllogaritjeve konstatohet se në sipërfaqen e banesës/banesave të tjera nuk mund të banojë/banojnë dot individi/familja për shkak të mospërmbushjes së kësaj norme, individi/familja nuk do të skualifikohet dhe aplikimi përkatës do të ndjekë procedurat e parashikuara në këtë udhëzues”.

“d. Gjithashtu në rastet kur individi/familja referuar dokumentacionit të paraqitur, apo në bazë të verifikimeve të kryera nga njësia administrative/lagjet në llogarinë e sistemit digjital të përcjellë nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës rezultojnë të ketë në pronësi/bashkëpronësi apo posedim të ligjshëm dy pasuri, ku njëra prej tyre shërben si shtesë anësore në objektin kryesor për të cilin është aplikuar, individi/familja nuk do të skualifikohet pasi ato do të konsiderohen si një pronë e vetme.”

ç. Në kreun IX, “Faza e dytë e aplikimit”, pika 8.1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“8.1. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social, Drejtoria e Rindërtimit, në bazë të urdhrat përkatës të kryetarit të Bashkisë do t’i vendosë në dispozicion të Sekretariatit teknik dosjet e subjekteve që kanë aplikuar për të përfutuar nga programet e procesit të rindërtimi si dhe familjet prioritare sipas sistemit të pikëzimit”.

d. Në kreun IX, “Faza e dytë e aplikimit”, pika 8.8 ndryshohet si më poshtë vijon:

“Kontrata për kalimin e banesave/shtëpive individuale në pronësi të përfituesve lidhet midis Bashkisë Tiranë dhe individit që ka kryer aplikimin pranë njësisë administrative/lagjes, duhet të shoqërohet me deklaratën noteriale të heqjes dorë nga subjektet përfituese nga çdo pretendim mbi të drejtat e pronësisë për banesën apo shtëpinë individuale të mëparshme, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në vendimin 904/2019 ose në aktin normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, si kusht për përfitimin nga programet e procesit të rindërtimit.”

3. Ngarkohen kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Njësitë Administrative dhe Lagjet e Bashkisë Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

K R Y E T A R

TONI GOGU